FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

# NAFAZOLINE

Tretësirë me spraj për hundë – 1 mg / ml (0.1%)
*(Nafazolinë nitrat)*

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**


1. Çfarë është Nafazoline dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Nafazoline
3. Si ta përdorni Nafazoline
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Nafazoline
6. Informacion i mëtejshëm


## 1. ÇFARË ËSHTË NAFAZOLINE DHE PËRSE PËRDORET

Nafazoline përmban lëndën vepruese nafazolinë nitrat, e cila është një agonist i receptorëve α - adrenergjikë. Ajo nxit kryesisht receptorët-α2 dhe në një shkallë më të vogël receptorët-α1. Në këtë mënyrë ajo shkakton ngushtim të arteriolave dhe të sfinkterëve të parakapilarëve, duke ulur rrjedhjen e gjakut në mukozën e hundës dhe në sinusoidet e erektuar. Për shkak të ngushtimit të arteriolave të sinusoideve të erektuara, ulet kongjestioni i membranës mukoze të hundës dhe rezistenca nazale, ndërsa rrjedhja e ajrit përmes hundës, rritet. Si rezultat i uljes së sasisë së gjakut në membranën mukoze të hundës, rritet diametri i qafës së sinuseve paranazale (përmirësohet aftësia për t'u tharë). Membranat mukoze bëhen më pak edematoze e kështu ndjesia e kongjestionit të hundës tek i sëmuri është më pak e shprehur.
Nafazolina e përdorur lokalisht (në mukozën e hundës) përthithet shpejt; fillimi i veprimit shfaqet brenda 5 minutash, kurse efekti zgjat 2 deri në 6 orë.
Nafazoline përdoret për trajtimin simptomatik të të gjitha formave të rinitit dhe sinuzitit; inflamacione të veshit të mesëm (dekongjestionim i gypave të Eustakit); hemorragji nga hundët (epistaksis); përgatitje për ekzaminime rinologjike dhe ndërhyrje kirurgjikale (si shtesë e anestezikëve lokalë).

## 2. PËRPARA SE TË PËRDORNI NAFAZOLINE

**Mos përdorni Nafazoline në qoftë se:**

- keni mbindjeshmëri ndaj nafazolinë nitratit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Nafazoline;
- vuani nga glaukoma me kënd të ngushtë.

Nafazoline nuk duhet të përdoret tek fëmijët.

**Tregoni kujdes të veçantë me Nafazoline**

Pyesni mjekun tuaj përpara se të përdorni Nafazoline. I sëmuri duhet paralajmëruar që mjekimi të mos zgjasë më shumë se 5 ditë. Në qoftë se është i nevojshëm një mjekim më afatgjatë, ai mund të vazhdohet pasi të ketë kaluar një interval prej 3 deri 5 ditësh pa mjekim.

Nafazoline duhet përdorur me kujdes:

- në të moshuarit;
- në të sëmurët me hipertension arterial ose me sëmundje të tjera kardiovaskulare;
- në të sëmurët me diabet;
- në të sëmurët me hipertiroidizëm;
- në të sëmurët me hipertrofi të prostatës.

**Marrja e barnave të tjera**

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Nafazoline.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Nafazoline në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- antidepresivë triciklikë;
- maprotilinë;
- frenues të monoaminoksidazës (IMAO).

Këto barna rrisin efektin presor të nafazolinës.

**Përdorimi i Nafazoline me ushqim dhe pije**

Nuk njihet ndonjë pasojë e Nafazoline kur përdoret me ushqim ose me pije.

**Shtatzënia**

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.
Të evitohet përdorimi.

**Ushqimi me gji**

Të evitohet përdorimi.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**

Nuk ka të dhëna mbi ndikimin e Nafazoline në aftësinë për të drejtuar automjetin, megjithatë duhet treguar kujdes derisa të shihni mënyrën sesi ajo vepron tek ju.

**Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Nafazoline**

Nafazoline përmban klorur benzalkoni, i cili është irritues dhe mund të shkaktojë reaksione në lëkurë dhe bronkospazëm.

## 3. SI TA PËRDORNI NAFAZOLINE

Gjithmonë përdoreni Nafazoline sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Nafazoline janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Për trajtimin e kongjestionit nazal (të rriturit) përdoret 1 spraj në secilën vrimë hunde, 2 - 3 herë në ditë.
Hemorragjia nga hundët (të rriturit): një tampon pambuku njomet me tretësirë Nafazoline 0.1% që futet në vrimën e hundës, ku mbahet për 2 deri 5 minuta.
Nafazoline nuk duhet administruar më shpesh se çdo 4 - 6 orë.

**Në qoftë se keni përdorur më shumë Nafazoline**

Në qoftë se keni përdorur më shumë Nafazoline se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë përdorur gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Simptomat e mbidozimit mund të përfshijnë: ulje temperature, përgjumje, bradikardi.

**Në qoftë se harroni të përdorni Nafazoline**

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), përdorni dozën në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Nafazoline mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Pas përdorimit të Nafazoline mund të shfaqet:

- irritim i përkohshëm i mukozës;
- dhimbje me djegie;
- kongjestion i përsëritur (efekti rebound);
- thumbim,
- teshtitje,
- ndjesi e tharjes së mukozës.

Përdorimi afatgjatë mund të shkaktojë:

- hiperemi reaktive;
- rinit atrofik;
- varësi ndaj barit.

Pas përdorimit lokal janë raportuar edhe efekte sistemike të tilla si: të përziera, dhimbje koke dhe marrje mendsh.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI NAFAZOLINE

Ruajeni në paketimin origjinal në një temperaturë 10° - 25°C.
Ruajeni nga drita dhe lagështia.
Mos e përdorni pas datës së skadencës.
Mbajeni larg fëmijëve. Bari juaj mund t'i dëmtojë ata.

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

**Çfarë përmban Nafazoline**

**Lënda vepruese** është nafazolinë nitrat.
1 ml tretësirë me spraj për hundë përmban 1 mg nafazolinë nitrat.
**Përbërësit e tjerë** janë: acid borik, klorur benzalkoni, mentol, alkol etilik, ujë për injeksion.

**Përmbajtja e paketimit**

Kuti me një shishe plastike 10 ml të pajisur me pompë sprucimi.

**Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:**

Mumd të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Spraj për hundë.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:**


**PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI



**Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2016.**


SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

**PAY ATENTION**, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.